



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1084/5 prot.,

Datë 06.05.2025

V E N D I M
Nr. 619/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.05.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MURATI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontrktor , Bashkia Patos

Ankimues: “MURATI” SHPK me Nipt J66702413V dhe adresë Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Patos
Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi “MURATI” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.03.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontrktor, Bashkia Patos

II.2. Në datën 04.04.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 11.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Murati” SHPK	8,380,720	lekë skualifikuar
2. “ITAL - PROJECT” SH.P.K	8,438,860	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 24.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5269, datë 25.04.2025 dhe me Nr. 1084/2025 Prot., datë 25.04.2025 e operatorit ekonomikë “MURATI” SHPK,, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimet si vijon:

“MURATI shpk ka marre pjese ne proceduren e mesiperme, me date 04.04.2025.

Ne daten 11.04.2025 njoftohemi ne Sistemin Elektronik te Prokurimeve Publike per Vleresimin ku shihet se jemi skualifikuar per arsyet te cilat i gjeni renditur me poshte. Shoqeria jone deklaroi se arsyeja e nxjerra nga KVO nuk qendron dhe per kete arsye paraqesim argumentimin si me poshte: Skualifikimi sipas KVO: mungon katalogu ose fragmenti i katalogut per produktin transformator fuqie 250 kvA, 6/0.4 kV, cu/cu

Argumentimi i shoqerise: Ne dokumentat e ngarkuara nga ana e shoqerise, mund te verifikohet shume lehte qe jemi te autorizuar nga distributori Enpi i cili eshte distributor i autorizuar nga Beta dhe ne sistem jane autorizimet perkatese, te perkthyer dhe noteruara ashtu sic kerkohen ne piken 2.3.4 te DST-ve se bashku me te dhenat perkatese te prodhuesit/distributorit. Gjithashtu nen dokumentin me emer itransformatori perkthim jane shume te qarta te dhenat dhe specifikimet teknike per transformatorin, te dhenat elektrike, se bashku me aksesoret perkates per transformatorin, ne fjale te perthyera dhe noteruara. Pra ky produkt eshte paraqitur nga ana jone shume i kompletuar dhe i detajuar. Kerkojme nga Komisioni i Prokurimit Publik anulimin e vendimit te skualifikimit dhe kualifikimin e ofertes tone si oferta ekonomike me e favorshme dhe shpalljen fitues per kete procedure.”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1084/1 prot., datë 28.04.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “MURATI” SHPK kundërshtoi me anë të ankesës me nr. 1084 prot, datë 25.04.2025.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1272/5 prot., datë 02.05.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1034/2 prot., datë 05.05.2025 me objekt “Vwnie nw dijeni rreth vendimit tw shqyrtimit tw ankesave”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MURATI” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se:

“Ne dokumentat e ngarkuara nga ana e shoqerise, mund te verifikohet shume lehte qe jemi te autorizuar nga distributori Enpi i cili eshte distributor i autorizuar nga Beta dhe ne sistem jane autorizimet perkatese, te perkthyer dhe noteruara ashtu sic kerkohen ne piken 2.3.4 te DST-ve se bashku me te dhenat perkatese te prodhuesit/distributorit. Gjithashtu nen dokumentin me emer “transformatori perkthim” jane shume te qarta te dhenat dhe specifikimet teknike per transformatorin, te dhenat elektrike, se bashku me aksesoret perkates per transformatorin, ne fjale te perthyera dhe noteruara. Pra ky produkt eshte paraqitur nga ana jone shume i kompletuar dhe i detajuar. Kerkojme nga Komisioni i Prokurimit Publik anullimin e vendimit te skualifikimit dhe kualifikimin e ofertes tone si oferta ekonomike me e favorshme dhe shpalljen fitues per kete procedure..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

1	Transformator Fuqie 250 kVA, 6/0.4 kV, cu/cu	cope	1
2	Pompe centrifugale me gjithë elektromotor dhe lëshuesit automatik me "soft starter", Prurja e pompes, $Q=110$ l/sek, Lartësia(Bruto me gjithë humbje) $H=12,5m$ Fuqia $P=22$ KW	cope	2.00

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “MURATI” SHPK, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Autorizim datë 01.04.2025 të shoqërisë ENPI SHPK për shoqërisë “MURATI” SHPK
- Autorizim datë 16.04.2015 të shoqërisë BETA TRANSFORMATOR ELEKTROMEKANIK SANT TIC LTD STI për shoqërinë “ENPI” SHPK
- Skedë teknike nga kompania BETA për Transformator të mbyllur hermetikisht me vaj me fuqi 250kVA

Dokumentat e sipërcituar janë të përkthyer nga përkthyesi ligjor I.P dhe të noterizuara pranë zyrës noteriale të noteres SH.Gj.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve

të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet

ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4 ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“ Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit

kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt – prokurimi “Transformator Fuqie 250 kVA, 6/0.4 kV, cu/cu” dhe “Pompe centrifugale me gjithë elektromotor dhe lëshuesit automatik me "soft starter", Prurja e pompes, Q=110 l/sek, Lartësia(Bruto me gjithë humbje) H=12,5m FuqiaP=22 KË” të përcaktuar në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të tenderit objekt - ankimi, duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën

shqipe, si dhe duhet që për këto artikuj të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues “MURATI” SHPK, në dokumentin e emërtuar “Autorizim transformator Enpi-Murati Beta” ka deklaruar se për produktin objekt prokurimi “Transformator Fuqie 250 kVA, 6/0.4 kV, cu/cu” ka ofertuar produktin “Transformator” të kompanisë prodhuese “BETA”, si dhe ka dorëzuar autorizim distributori nga kompania “Beta”, ku kjo e fundit me deklaratën e datës 16 prill 2015, autorizon kompaninë ENPI si si distributor dhe përfaqësues i autorizuar të BETA TRANSFORMATOR në Shqipëri.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP-ja konstaton, se në përmbushje të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës 8 të dokumentet e tenderit, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur, skedën teknike të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, në përputhje me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues “MURATI” SHPK me produktin e ofruar “Transformator Fuqie 250 kVA, 6/0.4 kV, cu/cu” të kompanisë prodhuese “BETA” ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit të kësaj procedure prokurimi..

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ofertues “MURATI” SHPK qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MURATI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-42242-03-24-2025, me objekt: “Blerje bazë materiale për ndërtimin e dy ministacioneve për përmirësimin e teknikave të ujitjes

dhe kullimit, skema të reja”, me fond limit 8,970,660 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2025 na autoriteti kontrktor , Bashkia Patos

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MURATI” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “MURATI” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro